

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 116/2023**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 34/2010  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT  
TË POZICIONEVE TË PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 34/2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

**K R Y E T A R E**

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën 2.11.2023